

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaWrap®-350 G Grid

RRJETË E VESHUR PREJ FIBRASH QELQI ME REZISTENCË NDAJ ALKALEVE PËR LLAÇE QË PËRFORCOHEN ME TEKSTIL

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaWrap®-350 G Grid është një rrjetë fibrash qelqi dy drejtimëshe, e pajisur me një veshje rezistente ndaj alkaleve, për t' u përdorur si pjesë e një llaçi të përforcuar me tekstil.

PËRDORIMET

SikaWrap®-350 G Grid e ngulitur mbi Sika MonoTop®-722 Mur përdoret për:

- Përforcimin e mureve prej tullash, bloqesh ose guri
- Përforcimin e mbushjeve të mureve
- Lidhjen e mureve me mure të tjera ose me struktura betonarmeje
- Shtimin e rezistencës ndaj dështimit jashtë planit të mureve subjekt i veprimit horizontal të tërmetit
- Shtimin e rezistencës dhe duktilitetit në plan të mureve subjekt i veprimit horizontal të tërmetit
- Riparimin e mureve me plasaritje

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë e lartë ndaj tërheqjes në të dyja drejtimet
- Ekonomik
- Nuk korrodon
- Veshje rezistente ndaj alkaleve

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ndërtimi	Orientimi i fibrës	0° / 90°
	Veshje SBR gri rezistente ndaj alkaleve Hapësira e qepjeve: 18.2 × 14.2 mm (distanca nga qendra në qendër)	
Lloji i fibrës	Fibër qelqi (E-glass)	
Ambalazhi	Gjerësi ruloni	50 m
	Gjatësi ruloni	1.0 m
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushtë të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.	
Dendësia e fibrave të thata	2.6 g/cm ³	

Dendësia e sipërfaqes		Fibra e qelqit	Me veshje
		Totali	280 g/m ² ± 5 %
		Baza (gjatësore):	145 g/m ² ± 5 %
		Fija (tërthore):	135 g/m ² ± 5 %
			360 g/m ² ± 3 %
			—
			—

Rezistenca e fibrave të thata ndaj tërheqjes 2 600 N/mm² (matur gjatë tjerres)

Moduli i elasticitetit i fibrave të thata në tërheqje > 80 000 N/mm²

Rezistenca ndaj tërheqjes	Baza (gjatësore)	Fija (tërthore)
	~77 kN/m	~76 kN/m

Shënim:
Vlerat e mësipërme janë tipike dhe vetëm treguese. Vlerat efektive varen nga cilësia e aplikimit dhe lloji i procedurës së testimit të tërheqjes. Aplikoni faktorë për reduktimin e materialit sipas standardit përkatës të projektuar.

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit SikaWrap®-350 G Grid ngulitet mbi Sika® MonoTop®-722 Mur.

UDHËZIME APLIKIMI

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Aplikoni shtresën e parë të Sika® MonoTop®-722 Mur (min. 5 mm) mbi nënshtresën e përgatitur. Ngulitni SikaWrap®-350 G Grid mbi shtresën e parë të freskët të llaçit. Ndërsa shtresë e parë është ende e freskët, aplikoni një shtresë të dytë të Sika® MonoTop®-722 Mur (~ 5 mm) për të mbuluar plotësisht rrjetën përforcuese. Nëse kërkohet përfundoni sipërfaqen e llaçit të freskët sipas kërkesave të projektit duke përdorur mallë druri ose plastike. Për informacione të mëtejshme, ju lutemi referohuni tek Method Statement “Llaç i përforcuar me tekstil”, Ref. 850 41 008 dhe skedën teknike të Sika® MonoTop®-722 Mur

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidate të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

KUFIZIME

Shih skedën teknike të produktit Sika® MonoTop®-722 Mur

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
SikaWrap®-350 G Grid
Qershor 2019, Botimi 01.01
020206020040000001

SikaWrap-350GGrid-sq-AL-(06-2019)-1-1.pdf